

INTERVISTË ME EDMOND PRUTHIN

Prishtinë | Data: 12 korrik, 2019

Kohëzgjatja: 74 minuta

Të pranishëm:

1. Edmond Pruthi (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Edmond Pruthi: Jam Edmond Pruthi, i lindur më 22 mars 1974 në Mitrovicë. Unë jom mitrovicali edhe familjarisht jemi nga Gjakova. Jemi familje e vogël Pruthi me tri rrënjë. Një rrënjë janë në Gjakovë dhe tri janë në Shkup. Me të tregu të drejtën në Gjakovë kam qenë pesë, gjashtë herë në jetë. Kështu kam shumë kushëri, po ma shumë jam koncentruar familjarisht në Mitrovicë dhe në Prishtinë.

Prej vitit '99 jetojmë në New York familjarisht dhe tash kemi vendosur që një pjesë e familjes të jemi edhe këtu që të rifillojmë biznesin tonë familjar që kemi pasë prej viteve të '80-ta në... ktu në Prishtinë. Shpresojmë që së shpejti të rifillojmë biznesin tonë edhe në Mitrovicë që është në pjesën veriore të Mitrovicës. Besojmë që së shpejti do të ndodhë edhe ajo se edhe atje kemi pronë.

Jam i lindur në vitin '74 kemi jetu në Mitrovicë së bashku me familjen e babit, gjyshin, gjyshën, axhën. Gjyshi im ka qenë Faik Pruthi që familjarisht mburremi me të dhe të tregoj ni detaj që para disa vjetve, katër, pesë vjet jam ndje mirë kur një në qendër të Gjakovës, një rrugë e ka emrin e gjyshit tim. Nga Mitrovica...

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na kallxu diçka ma shumë për to?

Edmond Pruthi: Po. Gjyshi, Faik Pruthi ka qenë luftëtarë në Luftën e Dytë Botërore dhe ka qenë në hierarki në politikën ma të lartë të Kosovës menjëherë pas luftës, pas Fadil Hoxhës. Por nuk i ka zgjatë shumë për shkak të mburrjes së tij dhe për shkak të vendimeve të tij që i ka personale që nuk ka pranë vendimet politike. Edhe shumë shpejt, pas pak vitesh ka përfunduar në Goli Otok në burg. Edhe ka qëndru dikund rreth tetë vjet në burg.

Edhe pastaj kur është liru ka qenë si një qytetar i thjeshtë i vendit dhe ka punu në ujësjellës, domethanë me ujë, ujë instalues. Pasi që është liru nga burgu, atëherë une s'kam qenë, vitet e '50-ta po flas, e ka pasë ni shtëpi të vogël në Mitrovicë ku kemi jetuar. Dhe pastaj, ai gjithnjë me ndihmën e shokëve të tij... ka pasë shumë shokë të mirë. Unë jom rritë pastaj me ta që kanë ardhë shpesh si mysafirë edhe kemi shku. Me ndihmën e shokëve, gjyshi im e ka pasë pastaj shtëpinë prej vitit '74-'75

shtëpinë në Prishtinë. Në rrugën e Dubrovnikut atëherë është qujtë, tash është Gazmend Zajmi. Edhe, domethanë mu m'ka ra njo ni vit e gjysë t'jetës tem në fillim me jetu në Mitrovicë pastaj në Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë shtëpia në rrugën e Dubrovnikut? Çfarë jete ka qenë? A keni jetu në qat' pjesë të qytetit? Qysh ka qenë qyteti?

Edmond Pruthi: Jetë e mirë. Mu m'kujtohet kur kom shku në klasë të parë në Shkollën "Vladimir Nazor" tash m'duket e ka "Naim Frashëri". Edhe ditën e parë prindërit m'kanë çu në shkollë, po ditën e dytë në klasë të parë kam shku vet. Është një lëvizje e lirë edhe e fëmive atëherë ka qenë. Tash edhe ne që jetojmë në New York edhe ktu në Prishtinë, s'ka fmi deri në klasë të katërt të pestë që shkon vet në shkollë. I çojnë ose prindtë ose transporti i organizuar. Ka qenë ndryshe. E mbaj në mend pastaj në vitin '81 kur kemi ardhë me jetu në Dardani në banesë te bashkësia e tretë lokale, e në vitin '82, '83...

Erëmirë Krasniqi: Ato kanë qenë ndërtesa t'reja a?

Edmond Pruthi: Po atëherë u lëshunë se babi edhe mami punonin në Obliq, në Kosovën B edhe në azotik edhe e morën banesën aty përmes punës ku punonin. Edhe më kujtohet në klasë të tretë kur kam shku me autobus, 1-shi edhe 2-shi, tash ku është Ministria e Arsimit ka qenë Fakulteti Teknik m'duket aty që është rrëzu. Prej ktu, prej Dardanisë ku është "Edi Club" ka qenë stacioni i autobusave, une në klasë të dytë, të tretë në autobus e shkoja vet në shkollë.

Ndoshta është edhe çështje sigurie ose s'di çka, ose edhe ledhatim i tepërt i fëmijëve në kohën e sotme, por nuk kam hasë të shoh fëmijë që shkojnë vet në shkollë në ditët e sotme. Po i shoh edhe kojshitë ktu në banesë që djalit, çikën për dore edhe shkojnë në shkollë (qeshë). Atëherë ka qenë, m'duket, ni liri ma shumë. Trafik ka pasë ma pak, automjete ma pak ka qenë ma qetë.

Erëmirë Krasniqi: Njerz të i kanë njoftë kojshitë e vet e...

Edmond Pruthi: Po, është edhe qajo. Unë kojshitë që i kam pasë atëherë, që i kemi pasë në Breg të Diellit edhe kta në Dardani i njoh edhe sot. Po kojshi që sot i kam te banesa nuk i njoh shumë, nuk i njoh. A janë qiraxhi, a i kanë t'vetat nuk e di. Edhe ni detaj t'vogël, në vitin '99 kur u ktheva...

Erëmirë Krasniqi: Veç pak ma kadale shkojmë...

Edmond Pruthi: Po.

Erëmirë Krasniqi: Qito banesat, jo të solidaritetit po qysh e patën emrin edhe nihere?

Edmond Pruthi: Jo kto janë banesat e termoelektranës përballë bashkësisë së tretë lokale.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë krejt banorë të ri apo kur janë ndërtu ato?

Edmond Pruthi: Të gjithë banorë të ri. Ndërtesat janë lëshu në vitin '81.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë?

Edmond Pruthi: Ka qenë shumë mirë. Ka qenë organizim shumë i mirë. Gjitha banesat kanë qenë të mbushura brenda në muji apo dy, kështu kur kanë hy banorët. Bile...

Erëmirë Krasniqi: A keni pasë shokë shoqe...

Edmond Pruthi: Po, atë deshta me thonë. Po kom pasë shumë, mos t'ia nisi me emra se ja u di edhe emrat krejtve (qeshë). Po kom pasë shumë shokë edhe shoqe. Edhe në detaj i vogël, në shoqe në Kanadë e kom tash, Mjellma Hatipi. Ajo i dojke shumë qejtë, unë kom fobi prej qejve. Po ajo shoqni e afërt që e kom pasë me Mjellmën, me Vesën motrën e saj, me Argjirën, Argjira Bislimi, shoqe e shokë të tjerë në hyrje aty që jemi kanë edhe hyrja tjetër. Gazmend Arifi, për shembull, u kanë një prej tyre. Ia nisa me dashtë qenin se lunin me në qen aty edhe une rrisha afër.

Edhe sot e asaj dite nuk kom qef shumë qej me pasë afër, a din? Po, po thom, që në qat' kohë ka qenë nifare ngrohtësie, nifare... i kemi pasë lojërat e pasditës. Ku është banesa që kemi jetu, prapa është ai parku i Dardanisë, parku i madh që është edhe aty u ulshim ose me letra ose me naj shah ose diçka, me lujtë diçka. Lujshin fëmijtë edhe krejt loja shkojke... ndoshta dy orë zgjatke ajo derisa u eliminojshin krejt që kush humbë, kush mbetë i fundit hupke e kush... tabllanet m'doket quhet ajo lojë. Me shku me marr në shishe ujë në banesë (qeshë).

"Nalne këtë lojë shkoni dy, tre vetë merrni ujë", a din? (Qeshë) Po ka qenë si lloj gare. Më kujtohet edhe Lagja Emshir tash që është e stërmbytur me ndërtime, atëherë si fëmi e kalojshim rrugën prej banesave tona qaty përballë është, te parkingu i madh. Edhe e kalonim rrugën, aty ka pasë kollomoç të mbjellun kështu... a ka qenë tokë e nacionalizume a s'di çka, po shtëpiat kanë qenë shumë larg prej rrugës që shkon për Veternik. Edhe shkojshim merrnim kollomoç. Po me na ble babi mami me qese me na dhanë s'i hajmë, po kështu nifare qefi e merrsha ata kishe p'e pjekë vet. S'dishim as me pjekë (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë popullsi e ndryshme prej tona anve a...

Edmond Pruthi: Po, po janë kanë... edhe kjo është e mirë. Gjatë verës une e kom pasë problem s'kom pasë katun, s'kom pasë ku me shku. Kom nejt në asfalt ktu në Dardani edhe në deti. Krejt shoktë e mi... që m'u kujtu Armend Sadiku edhe Artan Sadiku. Për shembull, shkojshin, s'di ku shkojshin vlla, në katun te dajtë, a s'di ku shkojshin. Kur vishin në fund të verës floktë e sarita ktu prej diellit, a din? Thojsha, "Ku jeni kanë bre? Çka jeni zbardhë?" A kiej t'zi.

Unë e kom pasë edhe, Orhan Avdiu, është ktu në Kurriz jeton tash. Na dytë mbetshim në ndërtesë aty, rrishim tonë verën se s'kishim ku me shku. Katunin ma të afërmin që e kom pasë familjar janë kanë dajhtë e nanës në Llukar a din? Po edhe aty jom shku kaniherë. Bile me thanë që kesh. Kaniherë boj hajgare me familjar edhe me shoqni thom, "Une hala me katër kamë t'vogël e di qeni e maca edhe me katër kamë t'mdhaja lopa, kali. Mshtjerra e ksi mzata s'e di as cili është" (qeshë), sepse nuk kom pasë kontakt. Domethanë, kemi nejtë qaty në Dardani ma shumë.

Erëmirë Krasniqi: A keni shku në Shkollën "Dardania" a...

Edmond Pruthi: Po. U hap Shkolla "Dardania" tash '84 ose '85, s'po më kujtohet, kom shku në klasë të pestë gjenerata e parë në "Dardani"...

Erëmirë Krasniqi: Pernime a?

Edmond Pruthi: Po. Edhe atëherë në bibliotekë ka punu edhe mikrofoni që punojshin altoparlantat nëpër shkollë. Kujdestare e kom pasë, të ndjerën arsimtaren e matematikës Zymrije Kavaja. Kemi qenë 23 çika edhe nëntë djem në klasë. Edhe kur na sherrat e ngucshim naj çikë ajo iu thojke çikave, "Po pak janë. Kapni rrehni" (qeshë). Edhe aty u kanë shumë, shumë klasë e mirë, shumë organizim i mirë. Edhe unë jom kanë pak sherr. Tash pse jom kanë pak sherr është për shkak që kur jeton në Prishtinë si një albinotip... domethanë është racë e veçantë një në 20 mijë njerëz në botë janë pa pigmente albinotip. Edhe të tjerët janë ngucakeqa tjetër a din? Edhe tash për me u mbrojtë duhesh me konë pak i keq për me bo ni...

Erëmirë Krasniqi: Distancë.

Edmond Pruthi: Jo distancë, po nifarë alibie që mos me tu afri a din? Edhe jom kanë pak... osht' Adem Miftari, osht' ende knej pari e kom pa, arsimtarin e... landa s'di a është tash Bazat e Arsimit Teknik - BAT. Edhe ai dojke me m'rreh me m'nal diqysh se... e bojsha atë... u sillsha pak keq ose agresiv për me e bo mbrojtjen tem. Po edhe në shkollë, shkolla u kanë e përbashkët. Domethanë, ma vonë në gjeneratat e ma vona ajo shkollë u nda si përgjysmë me mure kështu, po në kohën kur jom kanë une ka qenë e përbashkët. Kemi pasë edhe landë të gjuhëve të tjera anglisht, serbisht që i kemi...

Erëmirë Krasniqi: Qysh është qajo bashkëjetesë në atë kohë? A të kujtohet?

Edmond Pruthi: Po, po më kujtohet. Edhe "Edi Clubi", masi jemi qitu p'e tregoj edhe kta. Është lokal edhe në Prishtinë edhe në Mitrovicë që ka qenë i njohur për jo ndasi. Asnjëherë. Ka pasë nacionalitete të ndryshme, kanë luftë bashkë. Si vike puna për me nejtë, me pi najsen domethanë kafiteritë, aty u kanë kafiteria e ktyne, kafiteria e ktyne. Ose edhe të njejtin nacionalitet, kta janë rokerat, kta janë pankerat, kta janë ata ma kështu... prishtinalitë që folshin mrapsht, qysh iu thojshin? E harrova. Edhe

ka pasë ndasi kështu kapak, po nuk i kemi hetu ato. Edhe në Mitrovicë kom kalu masandej kohë të mirë të jetës, domethanë prej '88-ës qashtu diçka deri '95-ten '96-tën. Ku u hap kjo...

Erëmirë Krasniqi: Pse vendosët me shku në Mitrovicë?

Edmond Pruthi: Po babi, babi është Shkelzen Pruthi, njeri që na ka majtë në tul të bukës. Na ka majtë shumë mirë si familje. Njeri shumë familjar. Ende 72 vjeçar edhe punon në New York është, nuk ndalet. Po kjo, ta tregoj pak punën e ligjit ktu është obligativ penzionimi, në Amerikë nuk është. Është opsional, fakultativ. Kështu që, ke të drejtën me dalë në pension po sa t'ki fuqi puno nëse don. Edhe babi ende punon nuk ndalet. Babi e blejti ni lokal në Mitrovicë, në qendër të Mitrovicës...

Erëmirë Krasniqi: A jeni pronar edhe...

Edmond Pruthi: Po, po, pronar. Bash pronar. Edhe të kësaj edhe në Mitrovicë. E blejti ni lokal në Mitrovicë është dikund rreth 280 metra katror. Është i madh tre kat. Aty lindi ajo idea e ktij "Edi Club" se ka qenë i madh. Se kjo në fillim kur u hapë e ka pasë emrin "Café Edi". E vogël ka qenë. E masandej kur u hapë ai "Café Edi" tash qysh me qujtë kafe ai 280 metra katror shumë i madh edhe e bonëm klub i të rive. E qaty masanej edhe kësaj ia qitëm "klub" me kanë si ajo e Mitrovicës. E ai lokal tani na familjarisht na tërhjeki edhe në Mitrovicë edhe në Prishtinë, po une si i ri atëherë ma shumë rrisa atje, m'pëlqejke...

Erëmirë Krasniqi: E qysh keni fillu me qit' lloj biznesi? Kur e keni fillu? Në cilin vit? Edhe qysh?

Edmond Pruthi: E tash kështu, mos kesh qysh e kemi nisë se osht' ni histori shumë e mirë, e lezetshme. '83- '84 kur i kom pasë dhjetë vjet ose '85, qaty... se në '83-tën e ka ble babi e në '86-ën është hapë. Interierin e ka bo arkitekti Lulzim Nixha edhe kjo ka pasë me u bo kafiteri. Nashta quhen ende qashtu, po, separe, ato t'rregullume kështu që janë me {tregon me duar}... t'bukura të drunit. Janë kanë mjeshtrit t'u bo separetë ktu për me konë si kafiteri. Edhe une si fmi ktu iu sillsha nëpër sharra, nëpër... babi tash thojke, "Shko ma anej, ruju". U tutke që po vrahna najsen, po lëndona.

Edhe ka qenë ktu te, andej rrugës ku është Klinika Galaxy tash, aty ka qenë kafiteri. "Galaxy" është qujtë atëherë '83, '84, '85, qishtu, '84 m'duket. Edhe ata i kanë pasë disa, flipera kështu *pinball machine*, flipera edhe do video lojna. Edhe babi m'i jep mu do pare m'thotë, "Hajt shko". Me m'hjekë prej mjeshtrove, a din? "Hajt, shko luj qatje". Ka qenë ora 07:00, a 08:00 në mramje.

Kur shkova atje, jom kanë i shkurtë i vogël. Edhe e qita dorën në banak kështu në shank, "Ami do zhitona". S'e disha as sa zhitona m'vijne me ato pare. Edhe ni person aty që e rujke rendin, Hysi, kurrë s'e harroj edhe kemi shoqni edhe shumë mirë jemi tash se e ka edhe ni çajtoje atje te Gjykata e Qarkut përballë. Edhe Hysi punojke aty. I madh dy metra e dhetë njeri, kur t'ma ka fut shkelëm (qeshë) se une fmi. Tha, "Ec se ktu kafiq është, nuk është ktu për me lujtë fmitë".

Edhe unë erdha tu kajtë ktu në lokal. Tha babi, “Çka u bo?” Thashë, “Ma mshoi shkelëm m’qiti jashtë. S’më la se une fmi. Hajde ti me mu”. Babi s’mujke me ardhë se duhet me punu. Edhe qaty u kanë ai vendimi që, “Heki kto separea!” Babi i pruni video lojërat edhe e hapëm video lojëra. Ta vazhdoi veç pak qit’ histori. Mas nja gjashtë muajve, ai Hysi erdh ktu me lypë punë me u punësu (qeshë). E prej atëherit edhe shumë, shumë afërsi me qat’ Hysin. Nuk e kemi pasë me inat kurgjo, po qikjo është ajo *trigger* [shkaku], ajo ndezja që me hi me punu me flipera me video lojëra.

Erëmirë Krasniqi: A i bojshit ju, a ku i blejshit a? A e kuptojshit këtë lloj teknologjie? A ka qenë e hershme në atë kohë?

Edmond Pruthi: E ktu... shumë e hershme për ktu.

Erëmirë Krasniqi: Po de.

Edmond Pruthi: Shumë e hershme. S’ka pasë mjeshtër të programeve. Është... tash i thojnë App, veç e bon install edhe instalohet a din? Po atëherë u kanë ni program qishtë {shpjegon me duar} i madh me qipa, me procesora, me koneksione njama është me 28 kamë me tela kështu. Edhe ktu po më duket edhe sot s’ka që ndreq dikush asi, a din, nuk ka. Ka pasë në shtetet përreth mjeshtër t’mirë, po në Kosovë jo.

Ktu e kemi pasë ni mjeshtër. Ka qenë mjeshtri i televizorave, Ali Bunjaku, është në... qitash ishin çelë disa kafiqa në park atje që janë mrena. Në park kafiqat përmas që hyhet prej lartë kështu, gati te varri i Ibrahim Rugovës që është rruga, janë disa shpija që del rruga te Kacallarët atje, te Dodona. E qatje e ka, në shtëpi punojke ai. Rregullojke televizora kështu. Ali Bunjaku i ka rregullu video lojërat e kto krejt çka kemi pasë.

Shumë i mençëm, kurrë s’i ka pa përpara, po i durushëm. Ai kish durim me nejtë, me shiku, me analizu nashta dy-tri orë ni sen derisa i bijke në fije qysh me rregullu. E për këtë axhën Ali, me vazhdu ni sen tjetër. Kur e hapëm “Edi Club” me 6 qershor 2019, i patëm pesë video lojëra këtu. I kemi largu për shkaqe teknike, po do t’i sjellim prapë. Kur kenë ktu 13 video lojëra edhe shkova me thirrë axhën Ali për me i rregullu, se 20 vjet kanë nejtë mrena ktu edhe lokali ka qenë i mbyllun.

Edhe kur shkova te lagja aty hezitova pak, se sa herë shkojsa veç e çelsha derën, “Axha Ali!” Dilke dikush, a din, në oborr. Po hezitova pak se e disha moshën e tij tash, thojsha me thirrë a është ktu a s’osht’ qysh është puna s’e di, moti s’e kom pa. E pash Lulin, djalin e tij në oborr, “Lul,” thashë, “a është babi ktu?” Tha, “Po”. Kur t’kom piskat, “Axha Ali!” (qeshë). Dul. Dikun 78 vjeçar ish plakë, po erdh. Për katër pesë ditë prej 13 video lojërave ka bo kombinime edhe i aktivizoi, i boni të mundshme për me punu pesë prej tyne. Edhe tha që, “15-20 vjet unë s’kom prekë punë me dorë, veç po vi se qaty jom plakë me to”. E qishtë, s’ka pasë shumë mjeshtër knej.

Erëmirë Krasniqi: E ku i patët ble?

Edmond Pruthi: Në Gjermani. Fillimisht në Gjermani. M' duket ka qenë Ahen [Aachen] në kufi me Holandën. Qaty i ka ble. Babi ka shku edhe i ka marrë, i ka pru.

Erëmirë Krasniqi: E mandej sa, sa... prej qatij momenti gjithmonë ka qenë hapë deri në '99?

Edmond Pruthi: Po, u hapë kemi punu ktu, kemi pasë si biznes familjar. Domethanë, ka punu babi, mami, une, motra Valentina. E kom edhe vëllaun e motrën Ilirin e Vlorën, po ata kanë qenë të vegjël në atë kohë edhe e kemi majtë si familje. Pastaj kur u hapë edhe "Edi Club" në Mitrovicë, kjo pak filloi për me u zgjenu edhe familja s'mun me u çky gjithkah. Edhe fillum me marrë ma shumë punëtorë që me e mbajtë, po ka qenë biznes familjar kryesisht.

Erëmirë Krasniqi: E prind ma nuk punojshin në Obliq, a çka?

Edmond Pruthi: Jo, s'kanë punu prej '83- '85 qashtu diçka nuk kanë punu asnjoni në Obiliq, po kanë hapë biznes. Janë kanë shumë bashkëpunëtorë t'mirë babi me mamin, kështu bashkë.

Erëmirë Krasniqi: Okej. A po na tregon tash kalimin në Mitrovicë?

Edmond Pruthi: Kalimin në Mitrovicë, po. U kanë '88, '89, '90 se "Edi Club" në Mitrovicë është hapë me 7 dhjetor 1990. Fillimisht atëherë gjendja në krejt këtë federatën që u kanë me tetë njësi ke diqysh si, nuk dike ku po don me kërset luftë, diqysh si... gjithë ekonomia i nis luftat, masandej ia futin etiketime të ndryshme, po krejt te parja është. Po atëherë nuk ke mirë, nuk ke shumë sigurtë, stabile situata edhe video lojërat, fliperat janë... kanë qenë shumë shtrenjë. Po edhe tash janë, nëse gjinden dikund, shumë të shtrenjta.

Edhe lokali ka qenë shumë, osht' shumë i madh në Mitrovicë dhe ka qenë nifarë hezitimi qysh me investu kur s'po dihet çka po bohet, a din? Nëse kthehet situata, mendësia e situatës qysh u kanë në vitin '90 për shembull. Edhe e hapëm kafiteri fillimisht me katër bilardo. Edhe dy kate të tjera janë kanë kafiteri. Kati i mesëm ka qenë kafiteri e përgjithshme, kati poshtë atëherë u kanë shumë në modë ka qenë hapësira për çifte, çdo tavolinë u kanë me dy karriga kështu, u kanë shumë mirë. Edhe masandej u bonëm imun në atë situarë, a din? T'u prit çka po bohet. Po le bre çka po bohet po vazhdojmë jetën, çka me bo tash. Edhe babi vendosi me investu edhe e mbushëm me flipera, video lojëra, futboll në tavolinë. Kështu që edhe punum. Edhe lokali në Mitrovicë ka punu deri 24 mars '99...

Erëmirë Krasniqi: Qysh u përditësojshit ju me këtë farë botën e fliperave? Se kjo goxha e re, s'besoj që ka pasë shumë tjera që kanë ekzistuar në treg, qysh e keni ditë çka po ndodhë, qysh ia keni bo asaj pune, qysh i keni ra në fije?

Edmond Pruthi: Nuk ka pasë shumë, po babi vet, edhe une me babin nganjëherë, jo në shtetet e rajonit po ma larg, Austri, Itali, Gjermani, atje u kanë shumë në modë kjo. Domethanë, ka qenë gjithandej. Ka pasë lojëra të reja. Në fillim kur punum edhe në Mitrovicë edhe në Prishtinë deri kah viti '92- '93 i ndrrorshim programet. Qato App, a din, i ndrrorshim lojnat. Qitu u kanë Mortal Kombati, tash qite Superman-in se ka dalë, mandej qite Michael Jackson janë kanë do lojna qishtu. Dikur si në humor babi tha, "A din çka" tha, "u lodhëm bre t'u lypë se pak kish edhe të shtrenjta ishin ato programet.

Tha, "Po kom vendosë diçka..." osht' ide e mirë e biznesit për atëherë. Tha, "në vend se me i ndrru lojërat..." se ajo Arkada, domethanë maqina e njejtë ajo, video loja, po vetëm brenda i ndrrrohet programi, qajo App. Tha, "në vend se me i ndrru programet, hajde t'i ndrrorjmë klientat". Thashë, "Qysh me i ndrru klientat?" Tha, "Po kta të vogël po lujnë, po rriten, masnej shkojnë nëpër kafiqa. Masandej ata ma të vogël po rriten edhe kta po vijnë. Gjithë janë lojërat e njejta veç klientat, gjeneratat ndryshojnë".

Edhe ia nisëm, se ish edhe e vështirë kjo lëvizja vitet e '90-ta për me dalë në Europë me i ble ato me u kthy. Edhe përnime gjashtë-shtatë vitet e fundit ia nisëm me i ndrru gjeneratat, jo lojërat a din? Po mirë u kanë. Tash kur po vijnë klientat që janë rritë këtu, nuk janë vetëm të Dardanisë, po nuk janë vetëm të Prishtinës. Prishtina ka pasë edhe studenta, po edhe nxansa të shkollave të mesme që kanë qenë qyteteve përreth si tash që është Prishtina me pesë komuna, qysh është tash diqysh deri në Lipjan.

Shumë prej tyne kanë shku edhe në shkollë të mesme në Prishtinë. E sa i përket studentave, prej krejt Kosovës kanë ardhë në Prishtinë. Domethanë ka shumë që... njo ke i Istogut ni ditë që e kish kry fakultetin ktu në Prishtinë, e ke me shoqen e vet edhe me fmi ktu kur i patëm video lojërat. Djali i tij, s'di qysh e pat' emrin, djali i tij e bojke *swipe* këtë ekranin e video lojës, po ajo ni xhom nuk livrit, nuk është tablet (qeshë) po qajo është mendësia e rinisë t'sotme. P'e shoh tonë atë ekran aty, a përfundi osht' ekrani me gërrb që thojshin. S'punon me gisht, kape xhojstikun luj.

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Çfarë loja ishin? Përmendët diçka me... çfarë loja ishin? Michael Jackson, Supermario...

Edmond Pruthi: Supermario (qeshë). Kemi pasë shumë, shumë lojëra. Për shembull, lokali në Mitrovicë i ka pasë diku rreth 40 video lojëra. Prej ma të njofturve, lojërave ma të njohura u kanë Autofront, Autron i thojshin shqiptartë. Me kerr, me ferrari. U kanë njoni me femnën e vet edhe shkojshin në Miami apo ku po don me shku, e zgjedhshe aty ku po don me shku. Edhe ka qenë me timon kështu edhe kur hishe anash të dridhke ajo kështu (qeshë). Pak me qenë si ni iluzion i realitetit.

Masnej u kanë Operation Wolf edhe Operation Bear, dy lloj t'emrave i ka pasë. Po ne ktu, klientat i thojshin automati A47 me pushkë kështu. Ka qenë shumë e madhe si video lojë edhe për me i punu senzori i qasaj pushke a çka është ajo, për me punu senzori, për me punu në ekran nuk mundesh direkt në ekran po ka qenë pasqyre e pastaj *mirroring*. Pasqyrja e jepke qat' sinjalin programit atje që ku me vra dikond a ekrani u kanë poshtë. Ekrani në shishe në pasqyre naltë edhe gjushe kështu. Ajo u kanë shumë e popullarizume.

Nashta edhe në vitet e '90-ta ato sene janë kanë të popullarizume pak ma shumë kështu (qeshë), po ktu na veç në lojë. Edhe Mortal Kombati ka qenë. Mortal Kombati si tash që janë Fortnite e kto. Atëherë u kanë Mortal Kombati. Kick off u kanë ni lojë me futboll, tash e ki FIFA kto që janë ma të reja. Kto lojërat që po i përmendi kto krejt janë dy dimensionale, veç çka sheh, s'ka kthesa e kto, jo 3D e kto që janë tash.

Erëmirë Krasniqi: Sa zgjatshin? Edhe çfarë përvoje ish?

Edmond Pruthi: Mujshin me zgjatë tre sekonda mujshin me zgjatë tri orë, varet prej lojtarit. Ka qenë ajo, si humor ka qenë qysh me mrrri te mbretëresha ose krejt klientat qysh me mrrri te *kraljica*. Nejse, po tash mbretëreshë... ka staza të ndryshme, domethanë dhetë deri në 15 staza, varet prej lojës edhe bohet e vështirë e ma e vështirë. Krejt u kanë puna aty që me t'pa shoktë tu lujtë, shoqnia, edhe me shkru emrin në fund me tri shkronja. S'mujsh ma shumë, me tri shkronja.

Edhe tash tjetër vishin me lujtë ma gjatë që me ia thy rekordin dikush kush është i pari aty. Kick off u kanë ktu, masandej u kanë Atletika. Atletika u kanë kjo Olimpiada. Me gjujtë hedhsen, me kcy krejt i ka, me ngajtë e erdh ni... Iliri është qitu përmas "Edi Club" tash prodhojnë akull për kafiteri. Tha, "Kqyre gishti qysh më ka mbetë shtremt tu i mshu atyne tu lujtë" (qeshë). Shumë kujtime të njerëzve nin ktu, prej ktyne që janë rrit ktu.

Edhe njo tjetër, njoni ke me grunë e vet edhe me fmi edhe ishin shumë *in* kështu a din, në mes veti qysh folshin. Edhe ajo gruja tha, "E more papak, ti lujsh në qat' pushkën qatje une me shoqe u sillsha qitu t'kqyrsha e ti s'më shishe" (qeshë) a din? Simpati ajo kto, po tash ishin të martum, e kish arritë ajo qëllimin.

Erëmirë Krasniqi: S'ka pasë gra ktu? Çika të reja?

Edmond Pruthi: S'kanë hi po janë sillë qiknej për me pa simpatinë, a simpatia i habitun n'lojë tu mos e kqyrë. (qeshë) Po i thashë asaj, "E paske arritë qëllimin, për veti e paske bo mirë o'. Je martu".

Erëmirë Krasniqi: A e reflektojke politika në "Edi Club-in"? A vishin ndonjëherë me iu kontrollu ose çka po di?

Edmond Pruthi: Nuk... sa e mbaj në mend une edhe e mbaj në mend boll mirë se jom kanë non stop, krejt familja jemi kanë, që thashë bisnis familjar. Nuk kemi pasë asnjë rast. Në “Edi Club” në Prishtinë edhe në Mitrovicë kemi punu. Kemi punu normal prej mëngjesit deri në mramje. U ndrorojshin nxansat, kërkoj falje atyne arsimtarëve që iu kanë ikë nxansat prej orës për me ardhë kt,u po ka ndodhë edhe ajo shpesh. Po kështu nuk kemi pasë diçka, naj problem që mun me u thanë.

Problemi ma i madhi është që rehatija jonë si familje edhe e shumë njerëzve u destabilizua qatë në mars të ‘99-tës kur prej vitit ‘98, nuk e di a iu kujtohet a jo, po ka pasë lajme, jo sot po kryhet, jo nesër po kryhet, jo ishin do Rambuje e do qisi. Lajme non stop. Une atëherë i kom pasë 23 vjet edhe babi, mami edhe vëllau e morën këtë vizën turistike për Amerikë, për me shku në New York. Edhe nuk udhëtojshin se thojshin... s’u dike çka po bohet diqysh, nifare jostabiliteti.

Edhe me 17 mars ‘99, babi, mami edhe vëllau shkun si turista në New York. Se, po më duket me 15 mars ka qenë ai vendimi i Rambujesë edhe tha, “Hajt bre se s’ka kurgjo prej saj, po s’di çka po bohet. Po shkojmë...” tha, “po rrijmë nja ni muj edhe po kthehem”. Edhe une, Tina, Valentina edhe Vlora ishim ktu. Punëtortë ishin ktu në “Edi Club” në Prishtinë edhe në Mitrovicë. Edhe, “Hajt se na tre kujdesemi”. Motra e vogël u kanë 13 vjeçare atëherë, Vlora, “Po une e Tina kujdesemi për lokalet” nja ni muj ditë le të shkojnë në Amerikë, babi, mami edhe vëllau...

Erëmirë Krasniqi: A e kishit najkond atje, a qysh?

Edmond Pruthi: Po, babi e ka pasë çikën e çikës t’axhës atje. Ajo e çoi garancionin edhe ia dhanë vizën edhe babit edhe vëllaut edhe mami edhe shkun si mysafirë, si turista. Na metëm ktu edhe... po qashtu ke fati. Mas ni jave fillunë bombardimet.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi? A iu qitën prej shpisë, a qysh?

Edmond Pruthi: Kemi qenë në banesë ktu në Dardani. Me 24 mars ‘99 në ora 06:00 në mramje, në ora 08:00 kanë fillu bombardimet, 08:04. Edhe në ora 06:00 në mramje është mbyllë “Edi Club” në Prishtinë edhe kemi fol në telefon me Gani Xhakën, ka qenë bashkëpunëtor i yni shumë i mirë në Mitrovicë. Gani Xhaka, Shefki Maxhuni, Ferki Maxhuni, e shumë... Xhema, e shumë të tjerë që kemi punu bashkë, Besim Nura. Gjysma e ma shumë e ktyne kanë qenë drejtora, kështu menaxhment në Trepçë, po kur masat e dhunshme a s’di çka u bo në fillim të ‘90-tave, kur i qitën prej punës, babi i mledhi krejt në “Edi Club”, “Hajde punoni qitu” me mbajtë familjen diqysh. Babi i ka punësu 13 punëtor në Mitrovicë kanë qenë të punësun aty e ktu kanë qenë tre që kanë punu gjatë viteve të ‘90-ta.

Edhe u mbyllën lokalet metëm une me dy motrat në banesë. Të papërgaditun, se hajt me pasë përvojë prej naj bombardimi tjetër e tash përgaditesh a din? Edhe fillunë bombardimet, metëm qatë në banesë. Të nesrit... osht’ ni furrë “Arena” u kanë përpara qitu mbi Kurriz. Shkova me ble bukë edhe une

tash me atë procedurë normale ditore që e kemi pasë në shpi. Po shkoj në furrë po i thom, “Ami dy bukë” tha, “O djalë kur dilet prej shpisë merret ni thes bukë jo dy bukë” thashë, “Pse? Vi edhe nesër i blej taze”. Veç ma dha thesin me dhjetë bukë. Ni thes qishtu e ka qit aty edhe tha, qikaq kushtojnë, ia dhashë paret ma kthej kusurin e çova në shpi. Hera e parë që bleva me thes bukë.

Erëmirë Krasniqi: E pse a planifikojshin ata me mshel a?

Edmond Pruthi: Jo nuk planifikojke me mshel, po nuk kish siguri. Qaty tu ble bukë u lshu nifarë ksi, alarmi, nifarë alarmi u lshu a din? Nuk kish siguri. Edhe e çova bukën në shtëpi. Pesë ditë kemi nejtë në banesë, deri me 29 mars kur edhe u zbraz ndërtesa.

Erëmirë Krasniqi: A kërkoi dikush prej juve me dalë?

Edmond Pruthi: A?

Erëmirë Krasniqi: A u ndikutë prej tjerve me dalë prej banesës a qysh? A erdh dikush iu përzuni?

Edmond Pruthi: Jo, ishte... nuk e kom pa tu na përzanë po hajt po thojmë na përcjelli. U nisëm me kerre për Maqedoni. Na e murrëm kerrin e babit, Opel Ascona. Une me dy motra edhe me dy kojshi tjerë edhe tjetër mas neve edhe përpara neve në 06:00 mëngjes herët. Më kujtohet tu shku për Maqedoni në Lipjan, qaty te Lipjani, te ai udhëkryqi i Janjevës që është i kemi tejkalu tenkat, ni rend të madh të tenkave. Po, nuk jemi kanë na të partë që kemi tejkalu.

Masandej, në kufi kur folsha me kojshi e sene... po tenki i fundit i kish thonë, “Tejkaloni” kështu me dorë, a din? Masnej s’ka pasë kerre nëpër rrugë, shumë vdekun kështu s’di. Edhe në Kaçanik atje tu shku është ni shtëpi si e gurit, nuk e di a është ma. Edhe qaty ka pasë ushtarë, i kemi pa, bash ushtarë kështu të ushtrisë të ish Jugosllavisë edhe kemi shku në kufi. Në ora 08:00 në mëngjes jemi konë në kufi në Kosovë-Maqedoni. Edhe kerrin e kemi pasë dhezun. Hajt se qitash po dalim, gjashtë-shtatë kerre i kemi pasë përpara. Ni javë kemi nejt në Bllacë me...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë qajo përvoja në Bllacë?

Edmond Pruthi: Me dy motra. Katër ditë, tri ditë m’fal, po katër ditë ka qenë knej në territorin e Kosovës edhe nuk guxojshim me e dhezë kerrin për me u nxe se ftohtë u kanë, filimi i prillit ‘99. Natën ftohtë u bojke, kerri osht’ i hekrit edhe motrën e kom pasë t’vogël 13 vjeçare. Edhe... (shqetësohet)

Erëmirë Krasniqi: Mundesh me pushu.

Edmond Pruthi: Tri ditë kemi nejt në anën e Kosovës edhe s’mujshim me dhezë kerrin se me nxe pak se ftohtë natën. Kur e dhezim kerrin kah në 02:00-03:00 t’natës shpresojshim që sigurimi a çka do të

jetë policia a ushtria janë tu flejtë dikund janë rahat. Edhe e dhezshim kerrin pak bile një tre-katër minuta me fry nxehtë. Po me pendreka na mshojshin në haubë të kerrit kështu, na vishin se terr nuk u shike a din? Veç kur e najshe *bam* {onomotope} edhe e nalshe kerrin.

Se ndoshta ka qenë edhe strategji e tyre sa ma qetësi aq ma lehtë kontrollohet masa, se kish shumë kerre. Na ishim te kufini po gjatë ditës majshe me shëtitë te kolonat e kerreve, a din? Më kujtohet familja e Franklin Seda, shoku jem i vegjëlisë Roberti ka qenë ndoshta një 30-40 kerre ma përmas atje, gati te Shvarceni a çka është kjo e betonit që është. E thojshin që kolona është deri në Kaçanik atje. Nuk e di, nuk e kom pa une po qashtu thojshin.

Edhe çka m'ka lanë përshtypje kur na, kur na lanë me shku tutje në zonën neutrale, në mes Kosovës dhe Maqedonisë bash qajo Bllaca ku u konë qajo si kamp që u konë poshtë. Kur na lanë me shku nuk na lypen dokumentacion hiç në atë kabinën e kufinit aty po... ndoshta iu ka ndodhë kur luni letra a diçka që i boni ato vijat, një, dy, tre, katër edhe pesë kështu a din? Qashtu me vija na shkrujtën sa njerëz jemi në kerr. Na ishim tre. Edhe me dorë {tregon me duar}, shkoni. Hynëm... tash në zonën neutrale kemi nejtë edhe tri ditë tjera, domethanë shtatë ditë krejt.

Më kujtohet aty, në zonën neutrale, po ta kallxoj veç ni rast. Njerëzve që i njohim ktu në Prishtinë, deshta me përmend Mc Beka, Bekim Latifi, ish angazhu me Kryqin e Kuq a s'di me kond. Edhe vjen në 2:00 - 3:00 të natës m'sheh tu flejt une n'kerr aty edhe kërset në xhom. E kqyri, Beka. Thashë, "Çka po bon Bekë?"... qitu në Lakrishtë jemi rritë bashkë qiknej. "A po don tomel?" Thashë, "Jo faleminderit" (qeshë). U konë ni sen që aty në zonën neutrale kish qumësht, kish bukë me rrush të terun, po s'kish bukë normal. Hekma qit' rrush, a din? (qeshë). S'u hajke diqysh. Se kish ushqim po ma shumë kish ushqim si ma luksoz. Ama bre do ujë, a ka ujë se tomli... (qeshë)

Erëmirë Krasniqi: E kto ia jepke Kryqi i Kuq a qysh?

Edmond Pruthi: S'di, ni organizatë a s'di kush. Nuk e di. Masnej e kemi pasë vështirë kur dojshin me marrë diçka kur vishin me kamiona e qishtu ndihma prej Maqedonisë në qat' pjesën e Bllacës. Qatij kampi po na jemi kanë me kerre naltë. Edhe kur vike naj kamion, dilke naj basketbollist para neve aty edhe nuk... se ata veç gjujshin. Nuk majshe me marrë kurgjo që t'vyjke. Naj keks a naj, çka bishin si ndihma. Edhe kur i hapke durtë ni shqiptarë aty përpara i kapke krejt për veti (qeshë). Thojsha, "O vlla, u mushe, ruju veç pak se na ma t'vogël përmas". Ka pasë edhe sene pak humori kështu, a din? Pak me relaksu situatën edhe mas...

Erëmirë Krasniqi: Maqedonët nuk ju lejojshin me kalu për kët arsye mbetët në *medju* zonë - zonë neutrale?

Edmond Pruthi: Po, po. Në zonë neutrale kemi mbetë se Maqedonia nuk pranojke refugjatë. Edhe në të nejtën kohë disa ambasada të huja fillunë me i pranu refugjatët për me i çu në shtete të treta, ma

larg se Maqedonia. Po Maqedonia nuk bojke marrëveshje me qito... qysh i ngojsha lajmet qaty n'kerr a din?

Erëmirë Krasniqi: A i rroke prej naj njanës anë kanalet a? Kanalet e radios.

Edmond Pruthi: Po, prej Maqedonisë. Bile u konë edhe radio Haraqina, shqip ka pasë, i kapke. Viteve të '90-ta bile radion e kemi pasë të fortë. Antenën e gatë jashtë (qeshë), radio punojke super. Edhe ni moment tjetër, na ishim kryesisht shqiptarë, pat' edhe disa të komunitetit rom që i kemi pasë ngat të Ferizajit me kombi. Po ata lezet bre vlla, tona senet me veti, na të papregaditun. Bile na kanë ushqy kaniherë, na jepshin me hongër.

Ni moment erdh ni, s'e harroj kurrë, erdh njo prej Ambasadës së Turqisë aty edhe tha, "E kem marrëveshjen me qeverinë maqedone që njiqind automjete, kolonë me kalu nëpër Maqedoni, Bullgari edhe me shku në Turqi. Kurrë nuk e harroj, krejt shqiptarë edhe qata romët edhe ata folshin shqip, ashkali nashta, s'e di. Kur ia nisën krejt rrethi jem me fol turqisht. Thashë *uee* {onomotope} ku jom? Çka u ndrru? Ia nisën me fol turqisht e shkrujshin numrin, tabelen e kerrit, emrin e mbiemrin. Tha, "Ti a p'e shkrun?" Thasë, "Jo valla, s'pe shkruj. Çka me bo në Turqi?" Thashë, "Po dal në Maqedoni qitu nëse kemi fat me u bashku me familjen. Ose ata me ardhë në Shkup ose na me shku në New York, njanën se menen s'e kemi pasë me dalë prej ktuhit". Kishim jetë normale.

Edhe mas... kur u bonën ato njiqind kerre, une nuk u shkruva me motrën hiç në atë listë. Masandej Qeveria e Maqedonisë e kish injoru edhe ata, domethanë e kish anulë qat' kinse marrëveshje. Nejse, u rikthyn kta, u bonën krejt shqiptarë meniherë (qeshë). Nashta diçka e ronë është po qishtu realitet o ky, qaty m'ka ndodhë para syve. Kerri jonë nuk dhezke, u prish diçka. Opel disel, normal osht'. Sen mbrojtës i shqiptarit është diseli se harxhon pak. Nuk dhezke edhe e shtyjtem kerrin.

Tash thojsha kur të dalim në Maqedoni bile e tërhjekim me naj kerr tjetër a diçka deri në Shkup. Nëse s'gjejmë kërkund ku me flejt qita e kemi kulm mbi kokë, a din? S'ka tjetër, duhet tash me u gjind në situatën e re të pamendume ndonjëherë që na ndodhë në jetë. Aty u kanë edhe ni shok i jemi, ka vdekë në '99-tën mas luftës ndeshje ktu te Xhevdet Doda, te Katedralja, Albert Caka. Nana e vet shkoi me ni shpi aty kur kem në... kjo ka qenë bash në zonë neutrale. Edhe gjeti mill edhe bunar. E nxjerri ujin, me mill bojke diçka qaty edhe dru kish shporeti i druve qaty e dhezi edhe bojke veç, qysh me iu thonë? Pallaçinka kërrc kërrc {onomotope} a din? (Qeshë)

Veç e qitke atë brumin edhe the tash hajde qata, a din? Pak me kryp. Mill, krypë, ujë. Edhe Alberti ni moment, djalë i mirë shumë u kanë m'tha, "E more..." ai e ka pasë babën në Ministri të Arsimit...

Erëmirë Krasniqi: Paralel, të sistemit paralel?

Edmond Pruthi: Të sistemit paralel, u konë inspektor i arsimit. Edhe tha... e shtyjshin mujin me muj diqysh a din? Po, shok t'mirë e kom pasë, non stop bashkë jemi kanë. Une, ai, edhe Drilon Shala i "Art Photo" e kanë pasë qitu në Kurriz, djali i Naim Shalës. Edhe tha Alberti, "Ej more ju lokale, jetë të mirë. Une babën inspektor e ktu jemi njejtë". Thashë, "Po jemi konë edhe atje njejtë bre. Masi jemi konë shokë të mirë s'ka lidhje qysh e kemi pasë. Na jemi konë njejtë", "Jo..." tha, "po mendoj kushtet familjare". Domethanë, n'atë moment qaty s'ka pasë t'pasun, t'varfun, s'ka pasë. Janë kanë krejt njejtë.

Edhe nana e Albertit na ushqejke neve me qato buka se s'po di qysh me iu thonë. Dulëm e kalum kufinin, e shtyjtëm kerrin, dulëm anej. Kurrë s'i kom tregu qito përvoja, asniherë s'i kom tregu (qeshë). Edhe unë e kom pasë ni ndeshje me kerr në vitin '97 te rrethi tash ose udhëkryqi i spitalit edhe prej atëherit asnjëherë s'kom vozitë mo n'jetë edhe pse s'ka qenë faji jem aty. Edhe qaty kur dulëm prej kufinit e anej, ni djalë i veshun krejt bardh kështu, ni djalë i ri me xhemper, asi plletenica me pej që janë ato xhemperat. I veshun mirë djali. Mercedesin e mirë t'madh, s'e di me modele, po mercedes i madh. Tha, "S'po dhezë?" Thashë, "S'po dhezë. P'e kqyri qitu naj kombi a diçka me na tërhjekë deri në Shkup" tha... e hapi gepekin e mercedesit t'tij e qiti atë sajllen, atë tërheqësen. Tha, "Qe, lidhe" thashë, "Ja-a në këtë kerr s'pe lidhi". Ai shumë i shtrenjtë u doke kerri...

Erëmirë Krasniqi: I Kosovës, a i Maqedonisë?

Edmond Pruthi: I Maqedonisë, po unë nuk e njifsha. Ma vonë e njofta kush është. Mas nja ni muji e kom ditë kush është. Edhe u shtri, me qato tesha t'bardha u shtri në tokë e lidhi Opel tonë edhe në kerrin e vet. Tha, "Hec". Motra e tina refuzojke me u konë e tërhjekun se tha, "Kurrë s'e kom bo këtë punë, i mshoj kti kerri nuk di". Edhe qaty e kom thy atë betimin për mos me vozitë edhe qe tash deri në ditën e sotme asniherë s'kom vozitë veç qaty. Edhe asniherë s'kom vozitë prej atëherë, veç qaty e kom thy atë betimin tem kur m'ka tërhejkë ai...

Erëmirë Krasniqi: Kurrë s'ju ke kthi mo vozitjes a?

Edmond Pruthi: Kurrë hiç, asniherë. Veç qat' ditë që e kom mbajtë drejtimin e kerrit tonë deri në Shkup. Shkum aty, hinëm te ni automekanik në hyrje të Shkupit edhe numrin e telefonit të Amerikës nuk e kom pasë në letër se s'e disha ku çka na ndodhë derisa të shkojmë në kufi. Ku shkojmë, çka bohet, nuk e disha. Ni numër amerikan me gjetë thojsha mos po ma merr inati ai që m'nalë, ku çka osht' ky numër a din? Menimet shkojshin gjithkah. Edhe qat' numër të telefonit e kom mësu përmendsh ktu në Prishtinë edhe e kom përsërit nja ni javë edhe në kufi që për me pasë... me m'u kujtu.

E kom thirrë familjen atje prej qatij automekaniku edhe ata e kanë... janë kanë në dijeni që jemi mirë, jemi në Maqedoni. Mas ni muji kom shku me ni shok të fshatit... po, refugjatë kemi qenë në fshatin Studeniqan të Shkupit, 18 kilometra prej Shkupit. Edhe me ni shok temin i cili ka ndrru jetë para ni muji, Ismet Aliu, shkum në Saraj të Shkupit, osht' ni lagje atje shqiptarë ka shumë. Edhe qatje me ni

kafiteri p'e shoh qat' person. Mas ni muje që kesh në Maqedoni po e shoh qat' person ulun tri tavolina ma anej.

I thashë Ismetit, “Kush o qai njeri?” Tha, “Çka po të vyn?” Thashë qishtu qishtu, i tregova që na ka tërhjekë deri në Shkup. Tha, “Osht’ Enver Idrizi”. Jean Claude Van Damme shqiptar {qeshë}. Nashta ju e dini Enver Idrizin, karatisti i njoftun, po qe une s’e kom njoftë. Edhe shkova i fola, iu prezantova. Tha, “Po, po më kujtohesh”. E masnej Enver Idrizi e hapi ni diskotekë në Gjermani na ishim në New York. Erdh në New York me organizu ksi mramje... ma vonë ndodhë kjo, e kom pasë ni radio, radio “Melosi” në New York që i kom ndihmu me marketing me krejt. Metëm si shokë për ni tërhekne të kerrit që m’qëlloi qaty, po hala kom kontakte me Enverin, shumë njeri i mirë është. S’paku përvoja jem me to.

Erëmirë Krasniqi: Qysh shkut në New York masanej? U regjistru të me naj listë, a qysh u shkojke prej Shkupit në New York?

Edmond Pruthi: Po, me IOM, *International Organization for Migration*¹. Na jemi konë në Studeqan të Shkupit me motrat. Une me dy motra. Edhe babi, mami edhe vëllau janë kanë atje në organizatën IRC, *International Rescue Committee*, e cila ka bo këtë dokumentacionin e kto për refugjatë me ardhë në Amerikë. Edhe atje na kanë lajmëru në IRC edhe masandej kemi qenë, po më doket, në aeroplanin e dytë, a të tretë qishtu që kemi shku në maj, në maj të vitit ‘99.

Në Studeqan të Shkupit, du me cekë kto që jemi kanë në shtëpinë e plakut të katunit, u kanë Osman Atullahu, Osman Xhemajli hala është gjallë me tre djemtë. Shkojmë, vijmë shumë shpesh jemi familje nuk... ni muj e gjysë jemi kanë aty, po sikur me kanë dhetë vjet. Kemi kalu shumë mirë edhe hala kalojmë mirë. Edhe masandej me ni, Salla Univerzale është në Shkup. Na thirrën në telefon në 12:00 të ditës na thanë që në ora 05:00 me kanë në Sallën Univerzale, thu ti po shkojmë Prishtinë-Vushtrri. (Qeshë) Kadal se diqysh katër orë, pesë.

Edhe shkum aty, disa autobusa na çunë në aeroport. Nuk kemi hy në *check in* [kontrollë të pasaportave] e kështu, po direkt në pistë. Kanë qenë do dyrë me tela kështu, më kujtohet mramje. Në 05:00 ka pasë me u nisë prej Sallës Univerzale, në 08:00 u nisëm, në 09:00 kem në aeroport. Edhe ka qenë fluturim *charter* [privat]. Je hypë ni autobus krejt shqiptarë, veç ni aeroplan krejt shqiptarë është ni përvojë krejt ndryshe (qeshë). 300 shqiptar në aeroplan. Po mirë u kanë kështu, krejt të gzushëm, krejt s’ishin... une bile, për veti, s’e besojsha që jom t’u shku.

Edhe me qat’ aeroplan *charter* m’kujtohet ni sen që kur u çelën qato dyrë që hinëm na, ka pasë ushtarë amerikanë... që për mos me shku tash na si refugjatë me hi nëpër aeroport aty e nëpër pistë, po u kanë nifarë kanali kështu me ushtarë t’cilët janë kanë t’u përshëndetë kështu {tregon me duar} edhe drejt në shkallë të aeroplanit. Edhe kemi shku në New York, kemi... ka qenë fluturim përmes Dublin i Irlandës. Aty jemi nalë pak edhe tani në New York, qishtu kemi shku me 15...

¹ Organizata Ndërkombëtare për Migrim.

Erëmirë Krasniqi: Me çfarë ideje shkutë? Me idenë që po ktheheni a keni me nejtë në Amerikë?

Edmond Pruthi: Nuk e dishim, s'ka pasë ide të qartë. Ta tregoj edhe ni sen të vogël, në fshat aty në Studenqan janë kanë dy kafiteri kështu. Njana u kanë PDSH, do partia të atjehit, e une rrisha në të dyjat se s'dojsha me kriju përçarje si refugjat. Edhe i pam nja dy kamion me blloka t'kuq kështu, tulla për shpia me ndërtu edhe i thashë qitij Ismetit, shokut tem, thashë, "Ismet çka janë kta blloka?" Tha, "Te shkolla naltë në kodër ia kemi nisë me i bo shpijat për refugjatë, deri në 10-15 vjet tani kqyrim nashta ktheheni dikur në Kosovë".

Domethanë, në qat' kohë nuk ka pasë naj ide të qartë se çka ka me ndodhë mas ni muji, a mas ni vjeti, nuk u ditë, nuk e kemi ditë. Na kemi shku në Amerikë jemi taku me babin, mamin edhe vëllaun e kemi marrë ni banesë me qira në Bronx edhe ka fillu jeta diqysh sikur në mënyrë spontane, po hajde edhe pak, hajde edhe pak. Kur u kry lufta, une për shembull, me 4 gusht jom kthy, unë. Jom kthy ktu se... fillova atje me punu bile. E kryva nifarë kursi të gjuhës angleze në Marymount College në...

Erëmirë Krasniqi: A dishit ju nime anglisht?

Edmond Pruthi: A?

Erëmirë Krasniqi: A dishit ju anglisht? Familja juj?

Edmond Pruthi: Po, dijsim. Tina ka ditë, motra, vëllau ka ditë si 12-13 vjeçar edhe motra e vogël. Une disha me marrë vesh, po lidhsen, domethanë gramatikën nuk e kisha kërkun edhe s'mujsha me e fol, m'u shpreh. Po hinëm me ni kurs aty në Marymount College në Manhattan, ku ai mësuesi ka qenë i Ukrainës edhe tha që kush e mëson për dy javë anglishten ma së miri qitu ka me hi në punë në Marymount College si administratorë për me i regjistru studenta të ri.

Nejse, hina une në punë mar e prap se serbisht e shqip diqysh e qitsha, a din, nuk më vijke marre thashë p'e mësoj. Edhe në fund, mas dy jave prej qatyne nxansëve une e folsha ma së miri anglishten. Edhe aty kom punu po me 4 gusht une u ktheva në Kosovë. Unë vet, jo familja. Familja tha që në shtator vjen. Fillova punën në UNMIK, stacion policor numër 1 te Boro Ramizi aty që është, Pallati i Rinisë dhe Sporteve "Adem Jashari" tash. Boro e Ramiz e njohin krejt.

Qaty fillova me punu si përkthyes prej shtatorit '99 deri me 26 prill të vitit 2000 ku kërcënohem prej atyne që i intervistojshin policia edhe masandej shkova apat në Amerikë.

Erëmirë Krasniqi: Ti u ktheve kështu me idenë me nejtë?

Edmond Pruthi: Po. Edhe babi e mami erdhën në shtator, vëllau e motra fillun shkollën atje po me idenë për me ardhë në gjysëm vjetorin e dytë ose verën e 2000-tës ktu. Po qatëherë ka qenë ktu liri anarkike. Liri, s'po di qysh me thanë, liri shumë, po siguri të familjes, muj me thanë, që s'ka mujtë njeri shumë me pasë. Kështu që, kur menon për familjen thu, "Nal veç pak t'rri qitu". Mandej kur kthehesh, hajt edhe pak. Vit pas viti shtohen edhe obligimet ditore jetësore atje edhe mësohesh qysh me jetu me ni vend tjetër.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me "Edi Club-in" mas luftës?

Edmond Pruthi: Ky mbet i mbyllun. Prej përvojës t'babit që dëgjojke prej shokve të tij që i ka pasë në Angli, në Amerikë qishtë që kanë nejt si refugjatë që kanë pasë lokale në Prishtinë, ka pasë shumë padrejtësi me dokumentacione. Ia lshojsh dikujt me qira t'i ndrojkje letrat, ta shitke, e shitke dy-tri herë. Masandej merru ti me gjyqe për me e kthy pronën tane, a din? Kështu që, babi nuk ka dashtë me lshu me qira asniherë. Ka mbetë e mbyllun për 20 vjet.

Kemi qenë të interesum për me ia lshu me qira ndonjë institucioni të sigurt financiar, bankave për shembull, për naj filial të vogël a diçka. Ata nuk e kemi arritë... une nuk e kom arritë, sepse visha ktu për me i bo qito punë sepse m'thojshin shoktë duhet me pasë dikond në prokurim atje, duhet me pasë njerin e une s'kisha njerëz edhe nuk e kemi lshu asnjëherë me qira. Kurse lokali në Mitrovicë u uzurpu mas konfliktit, luftës, çka dush quje '99-ës. Na edhe sot, 20 vjet ma vonë une nuk e di kush e ka lokalin tonë.

Erëmirë Krasniqi: Ju thatë që e kishit në veri?

Edmond Pruthi: Po. Nuk e di kush e ka. Thashethame ka sa të dush, kështu që dëgjon po, thojnë që u stërshitë shumë herë. Njani-tjetrit ia kanë stërshitë. Thonë se ka qenë edhe diskotekë e market e barnatore e gjithçka tjetër. Osht' shumë në qendër, është te udhëkryqi kryesor rreth urës së Ibrit, ku e kanë qit atë bustin. Bash qaty është, qajo ndërtesë 14 katëshe. Osht' në qendër, osht' në vend shumë të mirë, po na familjarisht nuk e dijmë për pronën tonë se kush e ka, nuk e di. Nuk mujmë...

Erëmirë Krasniqi: A keni pasë shtëpi atje?

Edmond Pruthi: Jo, banesën e kemi knej në anën jugore. Si fmi kemi... kom jetu une në Lagje të Boshnjakëve, në Mahallë të Boshnjakëve në Mitrovicë, po ajo shtëpi u shitë prej gjyshit për me u maru kjo ku osht' në Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e vazhdu të jetën tani në Amerikë në të 2000-tën?

Edmond Pruthi: A në Amerikë po... ka qenë shumë i vështirë ni sen, se sa herë aplikojsha për punë diçka... se nuk mujshe me nejt, duhet me punu diçka, duhet me u marrë me najsen. Me vëllaun Ilirin, edhe pse i ri ai në moshë atëherë 14 vjeçar - 15 fillum... edhe pse para luftës e kemi bo këtë punën ktu ka pak si hobi, web zhvillim, prej vitit '96-'97 qishtu. Të tregoj që interneti për së pari herë ka ardhë në të '95-tën kush të thotë ndryshe të rren.

'95-tën edhe u kanë ni firmë, u qujke EU, EU.net e Beogradit. Edhe tash kur ankohen njerëzit, thojnë muji i internetit kushton qikaq, veç po tregoj që në '95-tën s'e kena pasë me muj e kena pasë me orë. I blejshe njiqind orë edhe hyshe *online* i *download website* [shkarkon faqet e internetit] që dojshe me i lexu a diçka e nalshe, dilshe *offline* edhe lexojsh *website*. Kurse tash telefonat nëpër xhepa 24h internetin qaty nal a lshutë s'e kqyrim, s'ka problem. U kanë vështirë. Masnej pat' ardhë PTK-ja e ka pasë internetin e dytë '95-tën njejtë. 160 orë u kanë maksimumi që mujshe m'i ble edhe nuk mujshe me i ble dy herë në mujt qat' 160 orëshin. Domethanë...

Erëmirë Krasniqi: Edhe nëse u harxhit u dashë me prit deri mujin tjetër a?

Edmond Pruthi: Jo, e kishim eu net-in. Ndash me këtë tjetrin me u kërrpit për me shty mujin, a din?

Erëmirë Krasniqi: E çka bojshit në internet në atë kohë?

Edmond Pruthi: Po, u kanë në atë kohë...

Erëmirë Krasniqi: A kishit imejlla?

Edmond Pruthi: Po. Une e kom imejlin tem prej '97-tës. Po edhe tjetër m'thojnë, "Pse nuk po e ndrron hotmailin?" Po qai m'ka mbetë i pari diqysh. Tash e kom edhe gmailin, po hotmailin e kom prej '97-ës. Emri, mbiemri jem është, Edmond Pruthi, qashtu e kom pasë edhe hala e përdori. Po është ni e keqe e hotmailit që t'i fshin arkivat. Po m'doket pesë-gjashtë vjet kur kalon t'i fshin emailat e përparëm. Qajo është e keqe kështu. Po kish edhe *website*, *Yahoo*, kështu u kanë shumë e njohun atëherë. Googli jo Googli u kanë si kurgjo hiç. U kanë *website* Kosova.com atëherë me lajme me çka po ndodhë kështu, e qitke ni link data, dita, muji edhe viti. E prekshe qat' link edhe u çelke ni HTML, ni faqe deri n'fund kështu, lexo lajme ti aty. Edhe veç e rujshe ti qato, u kanë si ni faqe me bo me u shtyp ato në A4 ishin 30-40 A4-sha. Veç e rujshe qata si HTML në kompjuter edhe...

Erëmirë Krasniqi: Kush i mirëmbajke ato?

Edmond Pruthi: Qendra për Informim të Kosovës, e LDK-së u kanë atëherë. Qata janë kanë. Mandej në vitin '97, '98 u çel edhe faqja e dytë Kosovapress-i. Edhe ata e patën bo qashtu me HTML. U kanë ni

faqe prej Amerikës që u majt, Albanian.com. Po ata nuk e freskojshin shpesh. Ka pasë faqe të rajonit, më interesojke çka po ndodhë. Ia nisi me na hi ajo kultura e minutit, a din, s’u pritshin lajmet e 7 e gjysve për me ditë çka po ndodhë.

Erëmirë Krasniqi: *Real time* [në kohë reale] a?

Edmond Pruthi: Po, real time. Edhe *Yahoo* u kanë shumë e mbushun me lajme, me informata të teknologjisë. Këtë shfletusin e internetit që e kemi përdorë atëherë u kanë *netscape navigator*, s’di a osht’ ma. Edhe e ka pasë edhe njo *netscape navigator* që u kanë ni editor ose krijus i HTML file i faqeve të internetit. E masanej kapak kapak hinën edhe programe ma të mira kështu. Me vëllaun atëherë, vëllaun e vogël, më kujtohet atëherë që në ‘97-ën vëllaun i ka pasë dymdhetë vjet qishtu, 13... osht’ ajo koha që ose ka me nejtë me shokë në rrugë ose ka me u marr me diçka. Edhe ni ditë, gjithnjë me babin, shkova në Beograd me autobus edhe e bleva ni kompjuter *big tower* ksëhtu u kanë Pentium 166, Pentium 1, 66 megahertz.

Edhe e bleva ata, i bleva kufjet, mikrofonin, krejt senet që vëllaun dojsa me ia bo që hajde bo muzikë ti, merru me diçka. Le ata, po 35 vjet vllau i ka bo reper osht’ (qeshë) edhe e ka hobi ata. Hala bon muzikë për qef, gjithë për qef ka bo. Edhe mirë ma ka pa hajrin qaty në fillim, po qitash sherrin ka fundi se s’ju ka hjekë ai qef.

Erëmirë Krasniqi: E çka u mësojshit me zhvillu? Web-faqe a çka bojshit?

Edmond Pruthi: Po e fillum me vëllaun për me bo web-faqe. Në të vërtetë, qaq shumë e kemi përcjellë qita Kosova.com, kta që ta thashë para lufte, edhe mas luftës... vëllaun ka qenë ai që në mënyrë vullnetare e ka bo *website* të tyre në vitin 2004. *Website* jo me ata linka ma po me *php*, e boni kështu me programim. Përndryshe, e ka kry vëllaun Pace University për software and engineering në New York edhe punojshim qishtu *website*. Masnej, une e hapa ni radio, radio shqiptare në New York. Radio “Melosi” u kanë...

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi? Pse? Çka u munojshit me adresu përmes asaj radio?

Edmond Pruthi: Para se me ta thonë kta për radio, deshta ni sen shumë të rëndësishëm me ta thanë. Osht’ *American experience* [përvoja amerikane], kush shkon në Amerikë e din çka domethanë kjo. Shkon në fillim aplikon për punë edhe çdo intervistë që shkon thojnë, “Do you have american experience?” [A ke përvojë amerikane?] Po ku me *have* [pasë] qe ni javë jom ardhë, a din? Une kom përvojë për qita që po aplikoj, qit’ punë e di me punu po përvojë amerikane, s’e di çka mendojnë me ata po, ktu a ke punu në Amerikë? Nëse s’ke punu në Amerikë e ki shumë të vështirë me hi nëpër punë. Po du me thanë punë nëpër zyre, se punë të tjera po.

Edhe u punësova në vitin 2000, në tetor të vitit 2000 në IRC, në qat' organizatë që na ka bo dokumentacionin. Qaty u punësova si vullnetar. U punësova, si vullnetar hina *IT Department* për me ndreqë kompjutera. Ta tregoj ni sen pak humor, shefi Charles Zunro hala është gjallë. Kur më murrë në intervistë, “*Do you know imaging?*” [A din me instalu kompjutera?] Menja jem që po më vet për photoshop, a din? Po more me *image* di me punu. Cruel, photoshop qisi s'ka problem. Edhe i thashë, “Yes”.

Hera e vetme që e kom rrejt atë njeri. Jo që e kom rrejt me shkak diçka kështu, po s'e kom ditë çka po më vet. Edhe nuk e disha çka është *imaging*, menojsa që është fotografi, po nuk ish puna e fotografisë kështu si dizajn...

Erëmirë Krasniqi: E çka ish?

Edmond Pruthi: Po *imaging* osht' kur ni kompjuter i instalohet krejt. *Windows*, *word* krejt programet edhe e bon *imaging ghost* e bon qat' kompjuter edhe nëse i ki 20 kompjutera të modelit të njëjtë mandej veç e restore, e qet qat' *imaging* në kompjutera tjerë edhe qikjo është *imaging*. Une kurrë në jetë s'e kom bo këtë sen, po ma dha qai' Charlsi ni kompjuter Dell GX 110 edhe tha, “Qe disketat...” floppy 1.44, dy disketa. 1-shi, 2-shi edhe, “Qe...” tha, “disketat për *imaging*”.

I kapa disketat, p'i shoh 1 But, aha qikjo p'e lshojka kompjuterin, buttiratka. E shtina disketen e dheza kompjuterin. *Insert disk two*. E shtina edhe tha, *select imaging file*. Okej, brows edhe p'e shoh disa files. Njoni po shkrun GX 110 që ish modeli i kompjuterit, e preka qata, pesë minuta *processing* edhe u lshu kompjuteri me *windows* e me krejt. Thashë a qikjo koka *imaging*. *Yes, I know*. E di qysh bohet. Edhe qishtu e mësova *imaging*. Por, paraprakisht i thashë, “Po, e di”.

Edhe tri javë punova si vullnetar, mas tri javë më murrën në punë si pjesë e *Support Specialist* [Specialist mbështetës] janë të knaqun me punën tem. Edhe s'më kanë pytë për *american experience* hera e parë. Edhe hera e parë që u punësova. Masandej m'kanë bo menaxhues, menaxher i *help desk units* të IT departamentit të IRC-së. Përndryshe, IRC është në krejt botën, ka qenë edhe në Kosovë. Ka dikund rreth dhetë mijë punëtorë momentalisht të punësum.

Osht' shumë organizatë e madhe. OJQ i thojnë, *non-governmental organization*, Edhe prej atyhit masnej edhe me vëllaun punojsha me *website* ka pak. Po atje, jashtë IRC-së gjithë m'ka njëkë nifarë dëshire me punu me njerëz me t'cilët jom rritë, me shqiptarë për shembull. Edhe atje kur kem, e çelëm ni shërbim Kosova Click. U kanë KosovaClick.com që shitshim *web hosting*, *domain*, *web design* me vëllaun për Kosovë. Klientat në Kosovë jo atje, a na në New York ishim.

Edhe masnej e hapa radio “Melosi” me muzikë të pastërt, se ia nisi muzika ndryshe edhe tash hajde une me majt procesin e muzikës gjallë. Kush? Edi. Nejse. Me Berat Gashin, Berati i Ulpianës qitu u rritë, e kom pasë shok shumë të mirë, e kom hala, jeton në Virxhinia. Edhe e hapëm radio “Melosin” edhe ia

nisëm me bo *party* [ahengje] për shqiptarët në New York. Domethanë, *party* kemi bo deri në vitin 2009 une e Berati bashkë çdo javë, çdo të premte.

Nuk është vështirë ktu ndoshta me bo *party*, se osht' plot shqiptarë, a din, edhe nja 200 vetë t'vijne diqysh. Po në New York me bo çdo të premte me të ardhë 200-300 vetë osht' pak vështirë, se vështirë është me i gjetë shqiptarë. Larg janë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u rrjetëzojshit?

Edmond Pruthi: Me kolegje. U kanë ide edhe e Beratit edhe e jemja. Shkum... se çdo koleg i ka kto klubet e studentave shqiptarë, spanjoll, portorikan. Edhe shkum në *admission office* [zyre e pranimit] aty edhe disa kolegje në Manhattan, Baruch, Hunter College e kështu. Edhe pytëm për klubin shqiptarë, na jepshin kontaktin e drejtusit të qatij klubi, masnej rrishim me ta. E bonëm ni staf në radio prej dymbëdhetë vullnetarëve, prej dymbëdhetë kolegjeve që e majshin ka ni emision në javtë, vullnetarisht. Edhe ata masnej me shoqinë e vet të studentave shqiptarë që i kishin nëpër kolegje u përbashkojshin diqysh edhe qishtu ia nisëm me bo *party*.

Prej atyne *party*-ve ishin ata dymbëdhetë vetë edhe une e Berati 14, edhe fitimi i *party*-ve u ndajke në 14 vena. Krejt ishim vullnetarë, po une e Berati ishim nismëtar, kurgjo ma shumë. Edhe qishtu ka shku deri në 2009-tën. Edhe jemi shoqnu edhe jemi rritë ma shumë kështu me shokë. Hala jom shokë me ta, i kom kështu në Facebook në Instagram gjithkah. Edhe kemi punu bashkë, mirë na ka shku. Edhe është *party* e vetme, Melosi *Party* në New York që u njoftë që s'kemi pasë ksi *bodyguard* [truproje] e ksi që e rujnë renin s'kemi pasë. Nuk ka pasë nevojë.

Diqysh, kur vike dikush që nashta mun me bo problem nuk e gjejke vetën në atë rrethinë të njerëzve. Ka pasë kryesisht njerëz të... studenta shqiptarë t'ri të Prishtinës, të Mitrovicës, të Pejës, të Gjakovës, të qyteteve të Kosovës. Kishim qef me na ardhë edhe të qyteteve të Shqipnisë apo Maqedonisë apo... po ata ato qefet muzikore ndryshe pak. Nuk e gjejshin vetën. E na nuk kishim, kangtë e vendeve të tjera nuk i kishim. Nuk dijkë Berati as me i lshu ato qysh shkojnë me rend. Edhe qat' herë pat' dalë, për shembull në 2006-ën disa këngëtare të reja ktu... 2003-tën, 2002-tën ia pat' nisë Arta me knu, Bajrami, ni stil të ri të muzikës. Masnej u kanë ma vonë Vesa Luma e kto.

Edhe krejt qato u lshojshin, po kish rajone kështu që ishin njerëz të ktij veni, po që nuk iu pëlqejshin ato muzika. Na s'e dijkim kur me lshu Gjyste Vulën ose s'e kishim hiç, çka me i bo tash? Po mirë e kemi kalu shumë. Deri në 2009-ën kemi bo.

Erëmirë Krasniqi: E kur u martutë ose kur keni fillu me jetën e juj...

Edmond Pruthi: E martesë po...

Erëmirë Krasniqi: Pyetje personale, a jeni njoftu në New York, apo veç e keni pasë lidhjen?

Edmond Pruthi: Jo, jo. Jo s’e kom pasë. Jo se shkum tash refugjatë, a din, në Shkup mandej në New York. Qajo u kanë në ‘99-tën, i kom pasë 25 vjet koha për me menu për me ia nisë dikur me kriju familje. Po nuk mujsha pa e marrë nënshtetësinë e Amerikës, se nëse e merr me *greencard*, nëse martohesh, kisha qef prej ktuhit me pasë grujen s’e di pse, qashtu m’u pat’ pikë. Ishalla s’e nin këtë intervistë (qeshë). Edhe në 2005-tën e mora nënshtetësinë Amerikane mas ni muji u martova.

Por, prej 2004-tës me Jehonën e cila është nga Podujeva ktu. Kemi pasë kontakt, jemi taku në 2005-tën u bona nënshtetas amerikan edhe u kurorëzum. S’e di pse, po u kurorëzum në Mitrovicë se m’tërhjekë ai vend aty. Qaty jom i lindun. Shkum. Hala e përmendim, “Pse bre u kurorëzum në Mitrovicë?” Po, qe (qeshë). Shkum edhe u kurorëzum qaty te axha Mursel. Krejt Mitrovicën e ka kurorëzu Murseli, e din krejt. Edhe në 2007-ën Jehona erdh në New York, fillum me jetu atje. Në 2011-ën u bonëm prind të Ronit edhe të Rikës. Ron është prej rrnon, po tash jo me dy ‘r-ja’, jo me ‘n’, po ma lehtë Ron. Osht’ edhe atje që shkon ai emër.

E emri i çikës... bineq janë. Emri i çikës është Rika, ka disa kuptime. Rika është rika e vogël, shota, ato patat e vogla, e rika është në gjuhën shqipe gramatikore. Kurse në Azi është emër, shumë *common* i zakonshëm. Në Azi thojsha mas nja 30 vjete, kjo kur t’i bon, kur të kryen fakultet mos p’i duhet për Azi ajte edhe s’ka problem, gjindet. A derisa është në Amerikë është Amerika lidhet Rika, qishtu osht’... Vlora, motra jem e vogla ia ka ngjitur emrin Rika. Edhe në 2011-ën, tash janë tetë vjeçarë. Jemi tash ktu. Pushim a zgjatje e pushimit. Pak në humor njani tha, “A je kthy për krejt?” Thashë, “Jo veç për veti”. Jemi ktu me Jehonën edhe me Ronin edhe me Rikën në këtë verë...

Erëmirë Krasniqi: Pse vendose me hapë “Edi Clubin” prapë?

Edmond Pruthi: Kalun 20 vjet edhe kisha, jo presion s’muj me thonë, presion të butë, të mirë, të njerëzve që njihemi...

Erëmirë Krasniqi: Të komunitetit, familja...

Edmond Pruthi: Edhe thojshin, “Hape bre, veç le t’jetë... se e kemi tash, na punojmë krejt në New York e kemi gjendjen e mirë, kështu që mujm me jetu jetë normale. Jo, si të Ramiz Lladrovci, ma poshtë (qeshë). Ni jetë normale (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Modeste.

Edmond Pruthi: Modeste (qeshë). Po, jo jo, shumë ma të ultë. Edhe çele, çele, çele, okej. Erdha në janar të këtij viti për disa punë ktu edhe e hapa derën. Gjithnjë në bashkëpunim me babin ose në marrëveshje me babin, se babi është pronar edhe i ktij edhe atij në Mitrovicë. Edhe e hapa derën ktu,

Milot, Miloti ni shok i jemi, Milot Hasimja, ka kalu ktu me kerr edhe po më shkrun në instagram tha, “A p’e çel ‘Edi Clubin’ a?” Une sa e çela ktu, marimanga krejt ish konë. Thashë, “Po, qe sa e hapa deren...” thashë, “M’ki pa?” Tha, “Po, kalova qanej” tha, “Le qashtu, po vi me bo ni storie”.

Bash shpirtnisht me bo ashtu e ka bo. “Ani”. Thashë, “P’e lo qashtu”. Për të martën u morëm vesh. Kur hina ktu me ni shok temin, thashë, “A p’i hjekim pak qito marimanga se shumë bre nuk sheh as kamera ktu kurgjo”. Përndryshe, dritaret janë kanë të thyme krejt. Ktu ka pasë teneqe prej jashtit për shkak t’ni bombe qitu në 2005-tën që ka kërsit. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: Te kafja e Enver Sekiraqës.

Edmond Pruthi: Po, po. Edhe u kanë me teneqe kështu, u kanë si hangar si... edhe ia nisëm kadal dale me rregullu masnej. Nuk u ngutsha, nuk ish punë që a po më shkon qiraja, a din diçka jo. Shumë kadal. Ka qenë edhe mjeshtri i rrymës, Ali Baruti, shok i babit edhe që u kudjes për neve për lokalet tona, për banesën gjithë edhe përpara. E ai hini kadal dale nja dy-tri javë ktu telat ku ishin prishë e sene i ndreqi instalimin e rrymës që është sen shumë i rëndësishëm.

Edhe punëtorët e tjerë krejt rend. Deshta me gjetë ksi që, me ly po kërkush nuk pranojke. Erdh ni... se i qesin nëpër internet qishtu 50 cent metri katror për me ly e kur vishin ktu, “Jo bre shumë kthesa kush e lyn kta mes ni javë ditë ktu”. Tha, “Me brush duhet me ly”. E masnej me Florim Gashin, osht’ arkitekt ktu, masterin e ka kry me ni shok. Tha, “P’e marr une vllaun tem”, tha, “kemi kohë kadal dale qaty e lyjmë”. Edhe nime, për nja ni javë e kryjtën, a din, kadale kështu.

Edhe u hap me 6 qershor. Ke shumë vendim spontan kështu, a din, edhe e hapëm. Po tash po shpresojmë që shumë shpejt e hapim edhe në Mitrovicë, e hapim familjarisht kështu. Pse jo?! Kom qef me konë, jo veç ktu, po në krejt botën me u nda njerëzit në të mirë e në të kqi, jo në kurgjo tjetër. Kemi jetu përpara shumë mirë, mujm me jetu prapë njëjtë.

Erëmirë Krasniqi: Nëse ki diçka që kishe dashtë me plotësu intervistën, që une nuk di as me të vetë, a din, a ka diçka që kishe dashtë me thonë për fund.

Edmond Pruthi: S’po di.

Erëmirë Krasniqi: Naj mesazh, najsen që të bjen në mend me plotësu naj tregim personal me naj aspekt tjetër.

Edmond Pruthi: Okej, kudo që je jetohet mirë kur don me jetu mirë. Kur don me u angazhu kudo që je ki me u angazhu edhe ki me përfitu për ni jetë normale. Kur jemi shku në Amerikë në vitin ‘99, si atje si ktu është. Qitu e ki gjelbrim, asfaltt, ni jetë të përditshme, tjetër është... veç tri sene i mungojnë

Kosovës, t'vogla, arsimi, ekonomia edhe shëndetësia. Veç qito trija, veç qito trija le të rregullohen edhe u kry. Osht' njejtë si në çdo vend përparimtar të botës.

Kom qef që krejt na me punu së bashku për vendin tonë, me qenë sa ma e mirë jeta. Me u ndalë ato... fjaltë e mira edhe bujare me i çu lartë njerztë që vjedhin, se ktu kom ni shumë shpesh po më thojnë njerztë, a ky ish, ky bre djalë, ia ka bo puntë familjes me do tendera. Po lej bre ato sene se duhet me kqyrë të mirën e përgjithshme se tek e fundit krejt na kemi me i rritë fmitë, e fmitë e tanë kanë me i rritë fmitë e vet qitu. Nuk është jeta veç e momentit që me dëmtu edhe pronën tonë, e prona jonë është vendi jonë, na jemi pronar të këtij vendi jo qeveria. Ata na i punësojmë me votë. I punësojmë, kryje punën si administrator po ky është vendi jonë. Duhet me u kujdes për pronën tonde, jo me ikë prej pronës. Kurrë kërkush nuk ikë prej pronës t'vet.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.

Edmond Pruthi: S'ka përse.